



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.873/2021

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), i përbërë nga gjyqtaret: Burim Ademi Kryesues, Zyhdi Haziri dhe Kymete Kicaj anëtar, duke vendosur përkitazi me apelin e kandidatit për anëtarë të Kuvendit Komunal në Komunën e Ferizajt Bekim Sopaj nga Subjekti Politik Partia Demokratike e Kosovës, me seli në Prishtinë, paraqitur kundër vendimit me numër 2948-2021 i datës 03.11.2021, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për Shpalljen e Rezultateve Përfundimtare për Zgjedhjet Lokale 2021, për Kuvendin Komunal, në seancën e panelit të mbajtur më datë 07.11.2021, mori këtë:

V E N D I M

Refuzohet i pabazuar apeli Anr.873/2021 i datës 04.11.2021, paraqitur nga kandidatit për anëtarë të Kuvendit Komunal në Komunën e Ferizajt Bekim Sopaj nga Subjekti Politik Partia Demokratike e Kosovës, me seli në Prishtinë për ri numërim.

A r s y e t i m

PZAP-i, ka pranuar një apel me datën 04.11.2021 nga kandidatit për anëtarë të Kuvendit Komunal në Komunën e Ferizajt Bekim Sopaj nga Subjekti Politik Partia Demokratike e Kosovës, me seli në Ferizaj, në të pohon se kanë ndodhur manipulime në vendvotimet në Ferizaj sepse ishte dashur në baze të llogaritjeve të kishte se paku 700 vota ndërsa në rezultatet e publikuara nga KQZ ka vetëm 255 vota, prandaj me bindje të plot konstatoj se ka pasur keqpërdorim dhe kërkoj të verifikohen të gjitha kutit në Qendrat e votimit në komunën e Ferizajt. Si dëshmi ka bashkangjitur deklaratat e 4 personave që e kanë votuar.

PZAP-i, pas shqyrtimit të apelit, vlerësimit të pretendimeve ankimore, dhe në kuptim të nenit 105 paragrafi 1, dhe nenit 117 paragrafët 2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

Apeli është i pa bazuar

Nga shkresat e lëndës, rezulton se kandidati për anëtarë të Kuvendit Komunal në Komunën e Ferizajt Bekim Sopaj nga Subjekti Politik Partia Demokratike e Kosovës, me seli në Prishtinë, ka parashtruar apel ku ka kërkuar nga PZAP-i, që të bëhet rinumërimi i fletëvotimeve në vendvotimin 2503D/03R. Pas verifikimeve të bëra nga ana e PZAP-it në qendrën e votimit 2503D/03R i njëjti rezulton se i ka 3 vota dhe vetëm një deklaratë, po ashtu në deklaratat e tjera nga dëshmitarët që i janë bashkangjitur apelit, nuk janë të cekura vendvotimet e plota por vetëm shkolla, pa e specifikuar saktë numrin e vendvotimit.

Paneli, vlerëson se parashtruesi i apelit në mbështetje të pretendimeve të tij, nuk ka ofruar dëshmi të qarta dhe bindëse lidhur me shkeljet e supozuara për mospërputhje të rezultateve, edhe pse në kuptim të nenit 117 paragrafi 3 të LZP-së, barra e të provuarit bie mbi ankuesin, në rastin konkret paneli, nuk mund të konstatoj se ka pasur manipulime gjatë numërimit të votave për kandidat të këtij subjekti politik, ashtu siç pretendon ankuesi, për faktin se thëniet e tij nuk mbështetën në asnjë provë konkrete por janë supozime sepse pritjet e ankuesit për të marrë më shumë vota automatikisht nuk nënkupton se ka mospërputhje të rezultatit si dhe llogaritja matematikore nga ana e ankuesit nuk argumenton shkeljet e pretenduara në apel.

Andaj, nisur nga arsyet e theksuara më lartë e në kuptim të neneve 115 paragrafi 1, 117 dhe 118 paragrafi 1 të LZP-së, paneli, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

Anr.873/2021 më datën 07.11.2021



Kryesues i Panelit

Burim Ademi

Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par.4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimit të këtij vendimi.